



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.5.2023

Nr: 504

Ora: 15:00

VENDIM

PËR

**EMËRIMIN KRYESISHT TË SEKRETARIT TË KZAZ-SË 82, BASHKIA DROPULL, PËR ZGJEDHJET  
PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “ç”, e pika 2, nenit 29, pika 5, nenit 30, nenit 31 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 7, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, si dhe udhëzimit nr. 2, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në KZAZ dhe KQV”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, në zbatim të udhëzimit nr. 2, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në KZAZ dhe KQZ”, të ndryshuar, ka miratuar me vendimin nr. 500, datë 12.5.2023 listën e shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësim të vakancës në KZAZ.

Me vendimin nr. 467, datë 9.5.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur shkarkimin e sekretarit të KZAZ nr. 82, dhe lënien e afatit prej tre (3) ditëve Partisë së Lirisë për të paraqitur propozimin e saj për plotësimin e vakancës së krijuar. Partia e Lirisë brenda këtij afati nuk ka depozituar asnjë kërkesë për plotësim të vakancës.

Në zbatim të nenit 3, pika 8, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, nëse partitë politike që kanë të drejtë të paraqesin kandidatura për sekretarë në KZAZ, nuk e ushtrojnë këtë të drejtë në afatin e përcaktuar Komisioneri emëron kryesisht sekretarët e KZAZ-së.

Data: 12.5.2023 Nr: 504  
Ora: 15:00



“Për emërimin kryesisht të sekretarit të KZAZ-së nr.82, Bashkia Dropull, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

Në nenin 2, pika 25, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, përcaktohet se zonë zgjedhore është bashkia në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, dhe se sekretari i KZAZ-së nr. 82 duhet të jetë me vendbanim në Bashkinë Dropull.

Në KZAZ-në nr.82, Bashkia Dropull vijon prej një periudhe të gjatë mosprezenca e sekretarit, edhe pas njoftimeve të vazhdueshme subjekteve për zëvendësim, të cilët referojnë pamundësinë e gjetjes së një kandidati (pavarësisht profilit arsimor) për të qenë sekretar në këtë KZAZ.

Në analizë të përmbajtjes së listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve, miratuar me vendimin nr. 500, datë 15.05.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, figuron vetëm një shtetase me vendbanim në Bashkinë Dropull, me arsim në shkencat e natyrës, për të ushtruar detyrën e sekretarit, shtetasja Aleksandra Shyqo Dhjamanti.

Pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, bazuar në testin e proporcionalitetit, rezulton se plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 30 dhe nenin 31 (bën përjashtim pika b, e nenit 31), të Kodit Zgjedhor. Kjo përzgjedhje vjen nga alternativa e vetme e mundshme për të mos krijuar ngërç me mungesën e sekretarit, për procesin zgjedhor në KZAZ nr.82, Bashkia Dropull.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “ç”, e pika 2, nenin 29, pika 5, nenin 30, nenin 31 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 7, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në KZAZ dhe KQV”, të ndryshuar,

#### **V E N D O S:**

1. Emërimin e zj. Aleksandra Shyqo Dhjamanti, në detyrën e sekretares së KZAZ-së nr. 82, Bashkia Dropull, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**